



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, nenit 40, paragrafi 40.2, pika **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të propozimit të grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2024, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.4.2024, miratoi

PLANIN
VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KRYEQYTETIT

I.

MIRATOHET Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2024.

II.

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahet mbledhja e Kuvendit të Kryeqytetit dhe pikat - temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Kryeqytetit.

III.

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqyteit me përmbajtjen e cekur në pikën II të këtij vendimi, është si në vijim:

4. Muaji prill:

- Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2024;
- Propozim-vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunksional, ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës - Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë-Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit;
- Propozim-vendimi për nismën e Kryetarit të Kryeqytetit për të hyrë në bashkëpunim ndërkomunal;

- Propozim-vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës sociale edukative “Don Bosko”;
- Propozim-vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projektregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01 nr. 110-1203, dt. 16.6.2010;
- Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese, Sinani dhe Selmani;
- Propozim-vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Propozim- vendimi për mirëmbajtjen e të gjitha hapësirat publike ose private, vizualisht të dukshme nga rruga, apo të cilat ndikojnë në mjedisin përreth, në pamjen vizuale dhe të pastër të Kryeqytetit;
- Propozim-vendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera;
- Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
- Diskutim lidhur me zyrtarizimin e Parkut memorial “ Të Pagjeturit”;
- Të ndryshme.

5. Muaji maj:

- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2023 (TM4);
- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2023;
- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 mars 2024 (TM1);
- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike “Pastrimi”, SHA;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike “Prishtina Parking”, SHA;
- Informatë rreth raportit për vlerësimin e performancës së Komunës (nga Drejtoria e Administratës);

- Informatë për ndarjen e bursave për studentë;
- Informatë mbi gjendjen e rinisë në Kryeqytet;
- Vizitë studimore e Asamblesë Komunale në Turqi;
- Të ndryshme.

6. Muaji qershor:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2024 (nëse ka vendim të qeverisë për rishikimin buxhetor);
- Propozim buxheti për vitin 2025 dhe Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027 (KAB);
- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike "Stacioni i Autobusëve", SHA;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike "Gjelbër", SHA;
- Seancë solemne "11 Qershori - Dita e Çlirimit të Prishtinës";
- Informatë për menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve në komunë;
- Informatë për rendin dhe qetësinë në Kryeqytet (Policia e Kosovës), dhe aktivitetet e KKSB-së;
- Informatë për drejtorinë e Sportit në Kryeqytet;
- Diskutim publik lidhur me buxhetin për vitin 2025 në pesë lagjet më të mëdha të Kryeqytetit dhe me dy takime në pjesët rurale;
- Të ndryshme.

7. Muaji korrik:

- Raport i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024;
- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 prill - 30 qershor 2024 (TM2);
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike "Trafiku Urban", SHA;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike "Sport Marketing", SHA;
- Informatë për raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij raporti;
- Informatë për zbatueshmërinë e rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm;
- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit;

- Informatë për punën e Drejtorisë së Pronës;
- Informatë për performancën e Komunës, MAPL;
- Informatë për realizimin e planit vjetor të Prokurimit Publik, 2023;
- Të ndryshme.

8. Muaji gusht:

Pushim

9. Muaji shtator:

- Propozim buxheti për vitin 2025;
- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike "Termokos", SHA;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve, të Ndërmarrjes Publike Banesore, SHA;
- Informatë rreth ofrimit të ndihmave me artikuj të ndryshëm për familjet me gjendje të rëndë sociale;
- Të ndryshme.

10. Muaji tetor:

- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2024 (TM3);
- Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike "Kuzhina Qendrore", SHA;
- Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Kompanisë rajonale të mbeturinave "Pallati i Rinisë", SHA;
- Informatë mbi zbatimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës;
- Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF);
- Informatë rreth shtrirjes dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës në Kryeqytet;
- Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë;
- Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025;
- Të ndryshme.

11. Muaji nëntor

- Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Shqyrtimi i projekt rregullores për tatimin në pronë;
- Informatë për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve për sezonin dimëror;
- Seancë solemne me rastin e festës 28 Nëntori;
- Të ndryshme.

12. Muaji dhjetor

- Raporti i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2024;
- Propozim vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
- Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Të ndryshme.

IV.

Për zbatimin e pikës III të këtij vendimi do të kujdesen: kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Kryeqytetit, drejtorët e drejtorive, drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe arsimore dhe Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

V.

Ky plan hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-030/01-54370/24, më 26.4.2024

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsy etim

Kuvendi i Kryeqytetit funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale dhe Statutit të Komunës së Prishtinës.

Sipas LVL - së, Kuvendi i Kryeqytetit nuk e delegon përgjegjësinë e tij lidhur me marrjen e Vendimit për planin vjetor të punës së tij (neni 40, paragrafi 40.1, pika d).

Kuvendi i Kryeqytetit, seancën e mbajtur 21.12.2023 si dhe në vazhdimin e seancës mbajtur më 22.12.2023, ka themeluar Grupin punues për hartimin e propozim planit vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2024.

Grupi punues ka mbajtur takim më 23.4.2024 dhe pas plotësimit ndryshimit të këtij propozim plani, i njëjti i dërgohet Kuvendit të Kryeqytetit për shqyrtim dhe miratim të tij.